


MNN Qendrore

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

9 Korrik 2025

Rajonet: Afrika, Azi-Paqësori, Eurazia, Mesoamerika, Amerika Jugut, dhe USA-Kanada



Konferencat Rajonale 2025

Që nga fillimi deri në mesin e viteve 1980, në një përpjekje për të krijuar Rajone më të bashkuara brenda Kishës globale të Nazaretasit, secila prej gjashtë Rajoneve ka organizuar një Konferencë Rajonale, e mbajtur në Rajon midis viteve të Asambleve të Përgjithshme. Zakonisht, Konferencat Rajonale planifikohen nga Rajoni, mbahen në Rajon dhe kanë për qëllim zhvillimin e Rajonit. Shpesh, shërbesa të ndryshme kanë kohë për të prezantuar dhe mbajtur workshope ose seanca për të promovuar këto shërbesa për një efektivitet më të madh. Në disa Rajone, ka pasur Konferenca Teologjike Rajonale që ndodhin para, gjatë ose pas Konferencës Rajonale për të thelluar ndërgjegjësimin dhe koherencën teologjike, me perspektiva Rajonale që informojnë bisedën teologjike. Konferencat Rajonale janë gjithmonë një kohë e miqësisë së rinovuar, rritjes së shtrirjes strategjike dhe angazhimit të thellë shpirtëror ndaj adhurimit të Zotit dhe misionit të Kishës së Nazaretasit. Këtë vit, në Shkurt, u zhvillua Konferenca M25 në Rajonin SHBA/Kanada, me fokus në Ungjillin: Sjellja e Njerëzve tek Jezusi.

Këto Konferenca M janë ekuivalente në SHBA/Kanada me Konferencat e tjera Rajonale mbi Rajone të tjera anembanë botës. Kanë mbetur tre Konferenca Rajonale midis Korrikut dhe Dhjetorit 2025: Korrik - Azi Paqësori, Tetor - Amerika e Jugut dhe Nëntor - Euroazia. Misionet Ndërkombëtare Nazaretase do të jetë në këto konferenca për t'u takuar me drejtuesit e MNN-së në çdo Rajon, për të ndarë plane për të ardhmen e MNN-së dhe për të filluar përgatitjet për Konventën Globale të MNN-së 2027.



Azi-Paqësori

173,839 Anëtarë

1,658 Kisha të organizuara; 666 Kisha të paorganizuara ende

914 Shërbëtorë të Liçensuar dhe 1,913 Shërbëtorë të Shuguruar në 55 Distrikte dhe 7 Fusha

Amerika e Jugut

360,142 Anëtarë

2,525 Kisha të organizuara; 423 Kisha të paorganizuara ende

1,984 Shërbëtorë të Liçensuar dhe 2,340 Shërbëtorë të Shuguruar në 83 Distrikte dhe 6 Fusha

Euroazia

279,112 Anëtarë

6,499 Kisha të organizuara; 1,013 Kisha të paorganizuara ende

1,080 Shërbëtorë të Liçensuar dhe 903 Shërbëtorë të Shuguruar në 47 Distrikte dhe 7 Fusha

LUTJE



- Lutuni që Zoti t'i përdorë këto Konferenca Rajonale për të zgjuar një frymë të re misionesh dhe për të thirrur më shumë në mision dhe shërbesë.
- Lutuni për drejtuesit Rajonal ndërsa po planifikojnë për secilën konferencë, dhe që udhëtimi për të gjithë pjesëmarrësit të jetë pa probleme në Rajonet ku ka konflikt.
- Lutuni që shumë të rinj të jenë në gjendje të marrin pjesë dhe që ekspozimi i tyre ndaj misionit të kishës ti çojë në thirrjen e Perëndisë në jetën e tyre për shërbesë.

LAVDËRIM



- Lavdëroni Zotin për besnikërinë e Tij ndaj Kishës së Nazaretasit dhe për praninë e Tij të shenjtë dhe transformuese në secilën prej këtyre takimeve.
- Lavdëroni Zotin për drejtuesit në gjashtë Rajonet e Kishës së Nazaretasit: Drejtorët Rajonalë, Koordinatorët Strategjikë të Fushave, Koordinatorët e Shërbesave dhe Mësuesit.

Një Shikim i Shpejtë MNN



Konferenca Rajonale e Azi-Paqësorit do të zhvillohet nga data 23-27 Korrik në Manila, Filipine, me temën: NGRIHU. Kjo do të jetë Konferenca e parë Rajonale që nga pandemia COVID dhe bashkon drejtues Nazaretas, pastorë, të rinj dhe zëra në zhvillim për një kohë inkurajimi, bashkëpunimi strategjik dhe ripërtëritjeje shpirtërore. MNN-ë do të marrë pjesë dhe do të ofrojë workshop mbi lutjen, një nga Pesë Fushat e Ndikimit, me Cheryl Crouch, drejtoreshë globale e MNN-së, dhe Christine Mosuela, presidente globale e MNN-së, si prezantuese. Konferenca synon të jetë më shumë se një ngjarje. Është një pikënisje për forcimin e kishave, zhvillimin e udhëheqësve dhe zgjerimin e dishepullizimit në gjithë rajonin.



Konferenca Rajonale e Amerikës së Jugut do të zhvillohet nga data 22-24 Tetor në Cali, Kolumbi, me temën: AME.25, që qëndron për Amar, Ministrar, dhe Evangelizar (Të Duash, Të Shërbesh dhe Të Ungjillizosh) si Jezusi. MNN-ja rajonale do të drejtojë workshopet: "Të lidhur me thirrjen", "Një mision, një popull", "Një qëllim", "Aktivizimi i misioneve në kishën time lokale" dhe "Pse misionet? Thirrja e të gjithëve". Drejtoresha Globale e MNN-së, Cheryl Crouch, koordinatoreja Rajonale e MNN-së për Amerikën e Jugut, Ruth Bravo, dhe Junior Rodrigues, koordinatori Mobilizimit të Misioneve Rajonale të Amerikës së Jugut, do të jenë prezantuesit. Të gjithë drejtuesit Rajonal të Amerikës së Jugut dhe fushave dhe distrikteve të rajonit janë shumë të entuziazmuar për këtë konferencë.



Konferenca Rajonale e Euroazisë do të zhvillohet nga 4-8 Nëntor 2025. MNN-ja do të organizojë takime joformale për të diskutuar pikat e forta, dobësitë dhe mundësitë për të çuar përpara misionet në kishat lokale në të gjithë rajonin. Tema e Konferencës së Euroazisë është MË SHUMË: Më shumë angazhim i brezit të ardhshëm; zhvillimi i udhëheqësve me karakter, adresimi i kishës dhe dishepullimit në një epokë dixhitale, kujdesi për emigrantët dhe refugjatët, kujdesi për krijimin dhe për të pambrojturit, dhe udhëheqja drejt shërbesës mes sekularizmit.



A mund të shërbeni?

A po ju thërret Perëndia të merrni pjesë në misionin e Tij në një botë të thyer? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT